



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/567/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"ENRAD", Sh.p.k. Gjilan Fabrika për prodhimin e radiatorëve dhe kaldave, Gjilan.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "ENRAD", Sh.p.k. Gjilan, Sh.p.k., Gjilan, me nr. prot. 24/567/MMPHI/Gjilan, për veprimtarinë: Fabrika për prodhimin e radiatorëve dhe kaldave.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/567/MMPHI
Datë: 17.10.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "ENRAD", Sh.p.k. Gjilan, pajiset për vazhdimin e Lejes Mjedisore për veprimtarinë: Fabrika për prodhimin e radiatorëve dhe kaldave, Gjilan, në ngastrën nr. P- 7040313-04952-3; nr. P-7040313-04952-4, zona kadatsrale Gjilan.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Mbetjet nga procesi teknologjik, të vendosen në hapësirë të betonuar dhe izoluar, ose të vendosen në kontejner të mbyllur;
- 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit te mjedisit që është përgjegjës për mjedis;
- 2.4. Të përmbahet në vazhdimësi kushteve të Pëlqimit Mjedisor;

Faqe 2 nga 4



- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 2.6. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është obliguar të kthej lokacion në gjendjen e mëparshme.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "ENRAD", Sh.p.k. Gjilan, me nr. prot.24/567/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrika për prodhimin e radiatorëve dhe kaldave, në ngastrën nr. P- 7040313-04952-3; nr. P-7040313-04952-4, zona kadatsrale Gjilan, është konstatuar se plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të datës: 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.16/3026/1-ZSP/146/16, të lëshuar me datë:11.08.2016;
- Vendim për leje Mjedisore me nr. 18/6500/ZSP/86, të lëshuar me datë: 20.02.2019.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjilan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së